



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

**Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i
skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt
standardeve**

Kodi: DA-PM-008

Rishikim nr 7
Dt: 14.11.2024

Faqe 1 nga 21


**Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet
drejt standardeve**

**Zbatues: Stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, anëtarët e grupeve teknike të
punës, anëtarët e bordit të akreditimit.**

Përgjegjës për zbatim: Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit.

Kontrolli: Menaxheri i Cilësisë
Ardita MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm
Pranvera FAGU

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	Kodi: DA-PM-008
		Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024
		Faqe 2 nga 21

1 Qëllimi

Ky dokument përcakton procedurën e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit për shtimin e aktiviteteve, vlerësimin e skemave të vlerësimit të konformitetit dhe menaxhimin e tranzicionit drejt standardeve/dokumentave të reja. Procedura synon të lehtësojë një qasje të harmonizuar brenda DPA, organizmave të tjerë akreditues, pronarëve të skemave të vlerësimit të konformitetit dhe palëve të interesuara.

2 Fusha e zbatimit

Procedura DA-PM-008 zbatohet në rastet e shtimit të një aktiviteti të ri për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (në tekstin e mëposhtëm: DPA), të skemave të vlerësimit të konformitetit (në tekstin e mëposhtëm: SVK) si dhe në rastet e tranzicioneve drejt standardeve/dokumentave të reja. Kjo procedurë nuk zbatohet për vlerësimin e SVK në rastet kur të gjitha kërkesat për këtë SVK janë të dokumentuara në një standard të vetëm të publikuar nga organi ndërkombëtar, rajonal ose kombëtar i standardizimit.


3 Përgjegjësitë

Kjo procedurë zbatohet nga stafi i DPA, anëtarët e grupeve teknike të punës, anëtarët e Bordit të Akreditimit. Është përgjegjësi e Drejtorit të Zhvillimit, zbatimi i kësaj procedure.

4 Referimet

Kjo procedurë referohet:

- Standardi S SH ISO 17011:2017 “kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit”, paragrafi 4.6,
- Standardi ISO 17000:2020 “Vlerësimi i konformitetit- Fjalori dhe parimet e përgjithshme”
- Politika e DPA mbi zgjerimin e aktivitetit DA-PO-004,
- Ligjit Nr. 116, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr 92/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në lidhje me ligjin 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”,
- Manualit të cilësisë të DPA, DA-MC-001
- Procedura DA-PT-001 ‘Procedura e akreditimit, mbikqyrjes dhe rinovimit’,
- Politika e Vlerësimit DA-PO-002,

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 3 nga 21</p>

- DA-FO-079 Formulari i aplikimit për skemën e vlerësimit të konformitetit
- DA-FO-080 Lista kontrolluese për vlerësimin e një skeme të vlerësimit të konformitetit
- IAF MD 25:2023 “Kriteret për Vlerësimin e Skemave të Vlerësimit të Konformitetit”.
- EA-1/22 A-AB: 2023 “Procedura dhe kriteret e EA për vlerësimin e skemave të vlerësimit të konformitetit nga organizma akreditues anëtarë të EA-së”.

5 Përkufizime

Përkufizimet që janë subjekt i kësaj procedure , që nuk janë të përfshira në *shtojcën 1 të Manuali të cilësisë*, DA-MC-001, kanë kuptimet e mëposhtme:

Aktiviteti i ri i akreditimit nënkupton shtimin e një skeme të re të akreditimit dhe/ose shtimin e një skeme të re të vlerësimit të konformitetit.

Pronari i skemës (PS)


Pronar i Skemës është një organizatë përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një skeme të vlerësimit të konformitetit. Pronar Skeme mund të jenë:

- Organizmat standardizues;
- Organet e Vlerësimit të Konformitetit (OVK);
- Organizatat që përdorin shërbimet e ofruara nga OVK;
- Organizatat që blejnë ose shesin produkte që i nënshtrohen aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit;
- Prodhuesit ose shoqatat e tyre që kanë krijuar skemën e tyre të vlerësimit të konformitetit.
- Organizatat e krijuara posaçërisht për këtë qëllim; dhe
- Autoritetet Qeveritare duke përfshirë rregullatorë dhe organe të tjera qeveritare.
- Organizmat akreditues nuk mund të jenë pronar skeme.

Skema e Vlerësimit të Konformitetit (SVK)

Skema e vlerësimit të konformitetit është tërësia e kërkesave të dokumentuara dhe të disponueshme publikisht në lidhje me:

- a) objektin e vlerësimit të konformitetit, p.sh., produkti, procesi, shërbimi, sistemi, personeli,

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 4 nga 21</p>

- b) kërkesat ndaj të cilave duhet të vlerësohet konformiteti;
- c) mekanizmin me të cilin përcaktohet konformiteti, metodologjinë për kryerjen e vlerësimit të konformitetit, p.sh. testimi, inspektimi verifikimi, validimi ose auditimi dhe çdo veprimtari tjetër mbështetëse për të siguruar konformitetin;
- d) çdo kërkesë e vendosur mbi OVK-të nga PS dhe çdo zbatim ose interpretim specifik i tij, nëse aplikohet;
- e) cdo zbatim ose interpretim specifik të ISO / IEC 17011, nëse është e aplikueshme.

Për qëllimet e këtij dokumenti, një SVK ndërkombëtare është ajo e cila zbatohet nga OVK- të e themeluara ligjërisht në më shumë se një vend anëtar të EA dhe që siguri i akreditimit për skemën në fjale sigurohet nga më shumë se një organizëm akreditues.

Të qënurit SVK ndërkombëtare nuk varet nga vendndodhjet ku përdoret objekti i vlerësimit të konformitetit.

Kërkesat specifike të skemës për organizmat e akreditimit

Kërkesat specifike të skemës për organizmat e akreditimit janë kërkesa specifike të përshkruara nga PS dhe që duhet të plotësohen për organizmat akreditues për kryerjen e aktivitetit të akreditimit në lidhje me SVK-në. Këto kërkesa janë shtesë të kërkesave të IAF, ILAC dhe EA si dhe të ISO/IEC 17011 dhe nuk bien në kundërshtim me to. Përbushja e këtyre kërkesave kërkon përpjekje shtesë nga organizmat e akreditimit në lidhje me burimet, procedurat specifike, kohën e shpenzuar për vlerësimet, raportimin, trajnimin dhe kompetencën e vlerësuesve, mbajtjen e shënimeve, mbajtjen e të dhënave etj.

Kërkesat specifike të skemës për OVK


Kërkesat specifike të skemës për OVK janë kërkesa specifike të përshkruara nga PS për tu plotësuar nga OVK që do të operojnë sipas SVK-së të tij, pa përfshirë rregullat e organizmit akreditues dhe standardit ndërkombëtar të Nivelit 3.

Autorizimi i një OVK nga pronari i skemës

Autorizimi i një OVK nga pronari i skemës është autorizimi i lëshuar nga PS që do të thotë se PS pranon certifikata, raporte, deklarata ose vërtetime të lëshuara nga një OVK për qëllime të konfirmimit që objekti i vlerësimit të konformitetit plotëson kërkesat e SVK-së të tij. Si rezultat, OVK është në gjendje të kryejë aktivitetin e vlerësimit të konformitetit të mbuluar nga SVK dhe mund të ketë të drejtën të përdorë markën e PS.

Shënim: PS-ve mund të përdorin formulime të ndryshme për të treguar/deklaruar/përshkruar autorizimin, të tilla si listimi, miratimi, njohja, përcaktimi, etj.

Rregullator është entiteti ligjor shtetëror që zbaton legjislacionin.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	Kodi: DA-PM-008
		Rishikim nr 7 Dt: 14.11./2024
		Faqe 5 nga 21

Organizmi Akreditues Shtëpi (hAB):

Organizmi akreditues i cili merr drejtimin për vlerësimin e një SVK ndërkombëtare që operohet në më shumë se një vend anëtar të EA. hAB normalisht, por jo domosdoshmërisht do të jetë organizmi akreditues nga vendi ku PS është themeluar ligjërisht. hAB duhet të jetë, në ato raste kur SVK do të zbatohet në disa vende, një nënshkrues i marrëveshjeve të njohjes reciproke me EA për skemën përkatëse të akreditimit ku përfshihet SVK-ja.

Pranimi i një SVK (nga një anëtar i EA):

Konfirmimi nga një organizëm akreditues i përshtatshmërisë së standardit që do të përdoret për të akredituar OVK-të që përdorin SVK dhe përmbushjen e kërkesave të përcaktuara për PS dhe vlerësimin e SVK-së.

Pranimi i një SVK ndërkombëtare (nga EA):

Konfirmimi i vlerësimit të kënaqshëm të SVK nga hAB dhe publikimi në intranetin e EA.

Shënim: Pranimi nga EA i një SVK të caktuar nuk nënkupton një gjykim mbi vlerën e tregut ose dobinë e kërkesave teknike të SVK-së.


Tranzicioni i një standardi në një standard tjetër nuk përbën SVK të re. Në këto raste DPA ka detyrimin të hartojë dokumentat e tranzicionit të cilat bazohen në vlerësimin e kompetencës, procedurave dhe kritereve sipas standardit të ri.

6 Përshkrimi i procedurës për shtimin e aktiviteteve të reja të akreditimit

6.1 Identifikimi i një aktiviteti të ri

Nevoja për të nisur një aktivitet të ri akreditimi mund të lindë në rastet kur:

1. Aktet ligjore (kombëtare dhe /ose evropiane), kërkojnë status të akredituar për një veprimtari të vlerësimit të konformitetit;
2. Publikimi i një standardi të ri të vlerësimit të konformitetit;
3. Në fushat specifike të ekspertizës, aktiviteti i vlerësimit të konformitetit i është referuar standardeve përkatëse (p.sh. ISO 50001, EN 9104, ISO/IEC 22003);
4. Një skemë të re të vlerësimit të konformitetit është zhvilluar dhe është aplikuar për akreditim në emër të pronarëve të skemës;
5. Futja e skemave të reja të vlerësimit të konformitetit nga organet e vlerësimit të konformitetit (si psh organet e certifikimit të produktit etj).

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve	Kodi: DA-PM-008
		Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024
		Faqe 6 nga 21

6.2 Analiza e aktivitetit të ri

Identifikimi i aktivitetit të ri të akreditimit nga legjislacioni dhe nga standardet dhe dokumentat e reja do të kryhet nga Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit.

Identifikimi i aktivitetit të ri të akreditimit nga aplikimet e OVK do të kryhet nga Drejtori i Drejtorisë së Testimit, Kalibrimit dhe Laboratoreve Mjekesore ose Drejtori i Drejtorisë së Trupave Certifikues dhe Kalibrues. Pesë ditë nga identifikimi, Drejtori i Drejtorisë së Testimit, Kalibrimit dhe Laboratoreve Mjekesore ose Drejtori i Drejtorisë së Trupave Certifikues dhe Kalibrues njofton Drejtorin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e Drejtorisë së Zhvillimit.

Brenda 10 ditësh nga marrja e njoftimit, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit bën një analizë të nevojës së tregut për aktivitetin e ri dhe për llojin e vlerësimit të konformitetit, të cilën ja paraqet Drejtorit të Përgjithshëm. Është Drejtori i Përgjithshëm i cili vendos nëse DPA do të fillojë përgatitjet për ngritjen e aktivitetit të ri ose jo brenda tre javësh. Në rastet kur identifikimi i aktivitetit fillon nga aplikimi i një OVK dhe nëse Drejtori i Përgjithshëm vendos mosfillimin e përgatitjes për aktivitetin e ri atëherë lajmërohet aplikuesi.

Nëse Drejtori i Përgjithshëm vendos fillimin e përgatitjeve për ofrimin e aktivitetit të ri, brenda pesë ditësh me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm formohet grupi i punës për analizimin e burimeve të nevojshme. Grupi i punës përbëhet nga të paktën: drejtori i përgjithshëm, drejtorët e drejtorive në DPA, menaxheri i cilësisë, dhe përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve. Në grupin e punës mund të përfshihen edhe specialistë të DPA ose persona kompetent jashtë saj. Analiza e burimeve kryhet sipas pikës 7 të kësaj procedure.

Në rastet kur ka ndryshime në kriteret për akreditim, tranzicioni ndiqet sipas udhëzimeve të lëshuara nga organizmat europiane dhe ndërkombëtare të akreditimit, nëse ka. Bazuar në këto udhëzime, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit, Drejtori i drejtorisë përkatëse që mbulon skemën e ndryshuar dhe menaxheri i cilësisë kryejnë analizën e burimeve sipas pikave 7.2; 7.3 dhe 7.5 të kësaj procedure. Nëse nuk ka udhëzime të lëshuara nga organizmat ndërkombëtare të akreditimit, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit, Drejtori i drejtorisë përkatëse që mbulon skemën e ndryshuar dhe menaxheri i cilësisë hartojnë udhëzuesit e DPA dhe kryejnë analizën e burimeve sipas pikave 7.2; 7.3 dhe 7.5 të kësaj procedure.


Në bazë të kërkesave të modifikuara dhe udhëzimeve ndërkombëtare DPA përcakton hapat dhe afatet për organet e akredituara, për të siguruar kohë për përgatitjen e sigurt dhe vlerësimin e përmbushjes së kërkesave.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit informon organet e akredituara dhe aplikantët rreth ndryshimeve të kërkesave në faqen e internetit të DPA.

DPA i bën thirrje organeve të akredituara me anë të një komunikimi se ato duhet të përgatisin dhe dorëzojnë planet e tyre për periudhën e tranzicionit brenda afatit të caktuar.

Drejtorja e Zhvillimit organizon kurset e trajnimit të nevojshme për përgatitjen e duhur të stafit të brendshëm dhe vlerësuesve të jashtëm.

DPA pasi vlerëson dhe mbledh planet e tranzicionit, përgatit planin e saj të tranzicionit si pjesë e planit të auditimit.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve	Kodi: DA-PM-008
		Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024
		Faqe 7 nga 21

Në rast se kërkesat ndryshohen, organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit përcaktojnë një periudhë tranzicioni. Pas skadimit të periudhës së tranzicionit, akreditimi për organet e akredituara që nuk i përmbushin kërkesat e reja revokohet nga DPA, ose revokimi mund të kërkohej vullnetarisht.

7 Analiza e burimeve

Grupi i punës brenda një periudhe jo më shumë se një muaj kryen analizën e burimeve të mëposhtme:

7.1 Analiza e vlerësimit të konformitetit

Grupi i punës vlerëson llojin e vlerësimit të konformitetit (niveli i dytë) dhe përcakton standardin (niveli i tretë) sipas klasifikimit të EA 1/06. Grupi i punës mund të përcaktojë edhe metodat apo standardet për kryerjen e vlerësimit të konformitetit (niveli i katert ose i pestë).


7.2 Analiza e burimeve njerëzore

Grupi i punës përcakton nevojën për burime njerëzore në fushën e kërkuar për akreditim. Për këtë arsye ai:

- Analizon kompetencën e DPA, nëse mund të zbatohet zgjerimi i aktivitetit të akreditimit, duke marrë parasysh burimet egzistuese për shqyrtimin e aplikimit, kryerjen e vlerësimit, rekomandimin për akreditim dhe marrjen e vendimit,
- Vlerëson dhe pranon ekspertizë nga burime të tjera të jashtme (ekspertë, vlerësues teknik, grupeve teknike të punës dhe bordi i akreditimit),
- Studion shkallën e trajnimit të stafit në këtë fushë si dhe mundësitë dhe nevojat për vlerësues teknik nga lista e vlerësuesve të DPA,
- Shikon mundësitë për trajnimin e stafit dhe vlerësuesve teknik jashtë vendit si dhe organizimin e trajnimeve të brendshme duke përdorur lektorë nga stafi i brendshëm ose lektorë të jashtëm nga vendi ose të huaj.
- Merr anëtarë të rinj për grupet teknike të punës (nëse është e nevojshme) për aktivitetin e ri të akreditimit.

Kur burimet njerëzore për personelin që merr pjesë në vlerësim nuk janë të mjaftueshme, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit kërkon vlerësues për fushën përkatëse brenda vendit. Informacioni për kërkimin e vlerësuesve të rinj, kriteret që duhet të plotësojnë i shpërndahen institucioneve të ndryshme shkencore, organeve të akredituar, grupeve teknike të punës, bordit të akreditimit, etj. Informacioni për vlerësues të rinj jepet edhe në Eëbsite-in e DPA. Përzgjedhja e kandidaturave për vlerësues kryhet sipas procedurës DA-PM-002.

Nëse nuk gjenden vlerësues vendas, atëherë zbatohet politika DA-PO-003, paragrafi 4.3 për gjetjen e vlerësuesve të huaj ose zbatohet procedura DA-PM-013 për nënkontraktimin e vlerësimit.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve	Kodi: DA-PM-008
		Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024
		Faqe 8 nga 21

Nëse nuk sigurohet kompetenca e marrësve të vendimit, atëherë kërkohet rekomandimi nga grupi teknik përkatës. Nëse nuk sigurohet kompetenca në marrjen e vendimit, Drejtori i Përgjithshëm automatikisht merr vendimin për mosfillimin e ofrimit të aktivitetit të ri të akreditimit.

7.3 Hartimi i procedurave dhe përfshirja në dokumentat e sistemit të menaxhimit

Grupi i punës vlerëson nevojën për dokumente zbatimi ose udhëzime. Sipas nevojës DPA adopton dokumente zbatimi ose udhëzime dhe /ose merr pjesë në përgatitjen e tyre. Grupi i punës sigurohet më parë që dokumente të tilla janë formuluar nga komitetet ose personat që zotërojnë kompetencën e nevojshme dhe përfshirjen e palëve të interesuara. DPA përdor dokumente zbatimi ose udhëzues ndërkombëtarë në rastet kur ato janë të disponueshme.

Gjithashtu DPA përdor udhëzues kombëtar ose ndërkombëtar për operimin e OVK. Kriteret për vlerësimin e OVK jepen në `Politikën e Vlerësimit` DA-PO-002, pika 3.

Grupi i punës harton procedurat e nevojshme dhe pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm, Menaxheri i Cilësisë i përfshin ato në dokumentacionin e sistemit të menaxhimit.

7.4 Analiza e burimeve financiare

Gjithashtu grupi i punës përcakton nevojat financiare lidhur me aktivitetin e ri të akreditimit në të cilin DPA dëshiron të zgjerojë aktivitetin e saj si dhe nëse është e nevojshme përcakton tarifën e reja.

7.5 Vendimi për aktivitetin e ri

Pas kryerjes së analizës dhe sigurimit ose jo të plotësisht të kërkesave për ofrimin e një aktiviteti të ri Drejtori i Zhvillimit i propozon Drejtorit të Përgjithshëm:

- a) Fillimin e ofrimit të aktivitetit të ri
 - b) Mos fillimin e ofrimit të aktivitetit të ri
 - c) Fillimin e ofrimit të aktivitetit të ri duke përdorur nënkontraktimin e vlerësimit.
- a) Nëse vendimi është fillimi i ofrimit të aktivitetit të ri, atëherë, Drejtoria e Laboratoreve testues, kalibruar dhe Mjekesore ose Drejtoria e organeve certifikues dhe Inspektues bazuar në burimet e siguruar ndjek procedurën e akreditimit sipas DA-PT-001. Brenda 7 ditësh nga marrja e vendimit, Drejtoria e Zhvillimit publikon në faqen zyrtare të DPA fillimin e ofrimit të aktivitetit të ri dhe kërkesat në lidhje me të.
 - b) Nëse vendimi është mosfillimi i ofrimit të aktivitetit, brenda 10 ditësh nga marrja e vendimit, DPA njofton klientin ose palët e interesuara për arsyet e mosfillimit të këtij aktiviteti.
 - c) Nëse Drejtori i Përgjithshëm vendos fillimin e ofrimit të aktivitetit të ri nëpërmjet nënkontraktimit të vlerësimit, atëherë Drejtoria e Laboratoreve testues, kalibruar dhe Mjekesore ose Drejtoria e organeve certifikues dhe Inspektues zbaton politikën DA-PO-002. Në këtë rast duhet të jetë e siguruar kompetenca e personave të përfshirë në vendimarrje.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 9 nga 23</p>

8. Pranimi i një SVK nga një organizëm akreditues

Pranimi i një SVK nga një organizëm akreditues kërkon:

- identifikimin e standardit më të përshtatshëm të vlerësimit të konformitetit që do të përdoret për të vlerësuar kompetencën e OVK(ve) pjesëmarrëse në SVK. Kjo do të përcaktohet duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit dhe përmbajtjen e deklaratës së konformitetit. Rrjedhimisht, ai standard do të jetë ai që përdoret si referencë për akreditimin e OVK(ve).

Shënim: SVK mund të duhet të ndryshohet në disa elementë në mënyrë që të mundësojë ovk(-ve) të përmbushin të gjitha kërkesat e standardit të zgjedhur.

- që SVK dhe PS plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë dokument. Pranimi nga një organizëm akreditues i një SVK-je të caktuar nuk do të thotë një gjykim mbi vlerën e tregut ose dobinë e SVK-së. Përgjegjësia për qëndrueshmërinë teknike dhe pranimi në treg i SVK-së i takon tërësisht PS-së.


Megjithatë, është përgjegjësi e organizmit akreditues të sigurojë që procesi i ndërmarrë për të siguruar qëndrueshmërinë teknike dhe pranueshmërinë e tregut të svk-së nga Ps ishte i përshtatshëm dhe i plotë.

Nëse një organizëm akreditues nënshkruet i MLA-së përkatëse ka vendosur, bazuar në një vlerësim pozitiv të kryer që një SVK konsiderohet i përshtatshëm si një SVK e nivelit 4 të MLA EA dhe akrediton OVK(të) për atë SVK, organizmi akreditues po deklaron se SVK mbulohet nga MLA.

9. Vlerësimi i një skeme të vlerësimit të konformitetit

DPA ndjek procedurën e mëposhtme për vlerësimin e përshtatshmërisë së skemave të vlerësimit të konformitetit:

- Aplikuesi duhet të dorëzojë në DPA formularin e aplikimit për skemën e vlerësimit të konformitetit sipas formës DA-FO-079 si dhe të gjitha informatat dhe dokumentet e nevojshme për vlerësimin e skemës së re të vlerësimit të konformitetit sipas formularit DA-FO-080.
- Pas dorëzimit në sekretarinë e DPA-së të dy formave DA-FO-079 dhe DA-FO-080 aplikuesi duhet të paraqitet në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve për lidhjen e kontratës me DPA sipas formës DA-FO-092, ku përcaktohet qartë marrëdhënia dhe kushtet e bashkëpunimit ndërmjet PS dhe DPA-së, tarifa e cila përfshin fazat e aplikimit, shqyrtimit dhe rezultatit përfundimtar (pozitiv/negativ). Theksojmë se kjo tarifë do të paguhet nga aplikuesi pavarësisht rezultatit përfundimtar që do të nxjerë DPA.
- Vlerësimin fillestar të aplikimit e bën specialisti i Drejtorisë së Zhvillimit brenda 1 muaji nga dorëzimi i të gjithë dokumentacionin përkatës.
- Pas përfundimit të këtij vlerësimi, specialisti i Drejtorisë së Zhvillimit dorëzon me memo vlerësimin e kryer së bashku me dokumentacionin përkatës tek Drejtori i Drejtorise se Zhvillimit, i cili merr masa brenda 15 ditëve për njoftimin e grupit (grupet) përkatës teknik të punës, palëve të interesuara dhe autoritetet qeveritare për organizimin e mbledhjes për analizën dhe vlerësimin e skemës. Specialisti i Drejtorisë së Zhvillimit i ngarkuar me analizimin e skemave shpërndan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tek

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 10 nga 23</p>

anëtarët e grupeve teknike të punës. Nëse grupi teknik i punës, palët e interesuara dhe autoritetet qeveritare rekomandojnë mospranimin e skemës, brenda 10 ditësh Drejtori i Zhvillimit njofton Drejtorin e Përgjithshëm i cili brenda 10 ditësh i dërgon aplikuesit vendimin për mospranimin e skemës dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi. Nëse grupi teknik i punës, palët e interesuara dhe autoritetet qeveritare kanë vërejtje në lidhje me plotësimin e kërkesave të skemës, brenda 10 ditësh Drejtori i Zhvillimit njofton Drejtorin e Përgjithshëm i cili brenda 10 ditësh i dërgon aplikuesit vërejtjet në lidhje me mosplotësimin e kërkesave të skemës. Aplikuesi ka të drejtë të dërgoj skemën e rishikuar jo më vonë se 6 muaj. Në rast të kundërt, ai duhet të aplikojë përsëri.

5. Nëse grupi teknik i punës, palët e interesuara dhe autoritetet qeveritare nuk kanë vërejtje në lidhje me plotësimin e kërkesave, i gjithë dokumentacioni do t'i kalojë për shqyrtim Bordit të Akreditimit, i cili jep rekomandimin përfundimtar për përshtatshmërinë e skemës. Mbledhja e Bordit të Akreditimit organizohet në përputhje me rregulloren e Bordit të Akreditimit.
6. Vendimi përfundimtar për përshtatshmërinë e skemës së vlerësimit të konformitetit merret nga Drejtori i Përgjithshëm i DPA brenda tre javësh nga marrja e rekomandimit të Bordit.
7. Vendimi i marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i komunikohet aplikuesit brenda 10 ditësh. Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit bën publikimin e vendimit për skemën e re në ëbsite-in e DPA-së brenda 10 ditësh.

10. Pezullimi ose përfundimi i një skeme akreditimi

Kur për shkak të ndryshimeve në legjislacion ose mungesës së interesit të tregut, është e nevojshme marrja e vendimit për pezullimin ose përfundimin e një skeme akreditimi në mënyrë të pjesshme ose të gjithën, ky vendim merret nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit. Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit e bazon rekomandimin e tij në analizën e mëposhtme:

- a) mendimin e palëve të interesuara për skemën përkatëse,
 - b) shqyrtimin e përmbushjes së kontratave me PS/OVK (ndërprerjen),
 - c) informimin e palët e interesuara në një komunikatë në faqen e saj zyrtare,
 - d) ndjekjen e komunikimit të jashtëm,
 - e) dhënien e deklaratës për vlefshmërinë e akreditimeve të lëshuara,
 - f) nëse paraqitet një SVK e re për të zëvendësuar të mëparshmet, publikohen rregullat e tranzicionit.
- Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit harton procesverbal mbi konsultimin dhe rezultatet e tij me palët e interesuara dhe përmbushjen e kontratave me PS/OVK.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 11 nga 23</p>

11. KËRKESAT PËR PS

DPA siguron që kushtet e mëposhtme janë plotësuar përpara se të bashkëpunojnë me një PS përveç rastit kur ndonjë prej kushteve nuk është i zbatueshëm për një SVK të veçantë:

11.1 PS duhet të jetë një person juridik, ose një pjesë e përcaktuar e një personi juridik, i cili është ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e tij.

11.2 PS ka autoritetin për të vendosur dhe ndryshuar kërkesat e SVK-së.

11.3 PS duhet të ketë të përcaktuar personin e autorizuar për të bashkëpunuar me DPA.

11.4 PS duhet të mbajë rregjistrime, dëshmi dhe arsytetime të mjaftueshme se aktiviteti i vlerësimit të konformitetit dhe standardi i përzgjedhur për akreditimin e OVK-ve është i përshtatshëm,

11.5 PS duhet të bëjë publike pa kërkesë një përshkrim të përgjithshëm të SVK-së. Dokumentet e skemës, duke përfshirë kriteret dhe procesin që do të përdoren në vlerësimin e konformitetit, duhet të jenë të disponueshme për publikun.

11.6 PS duhet të demonstrojë se SVK është e vlefshme. Vlefshmëria duhet të dokumentohet dhe të përfshijë aspektet e mëposhtme:


- i. Një përshkrim të qëllimit të SVK-së;
- ii. Një përshkrim të kërkesave të SVK-së;
- iii. Një analizë e përshtatshmërisë së kërkesave të vendosura për përmbushjen e qëllimit të përcaktuar të SVK-së;
- iv. Një përshkrim të metodave që do të përdoren për përcaktimin e përmbushjes së kërkesave;
- v. Një analizë që tregon se metodat e përshkruara që do të përdoren për përcaktimin e përmbushjes së kërkesave janë të përshtatshme;
- vi. Vendimi për aktivitetin e vlerësimit të konformitetit që do të përdoret (përfshirë identifikimin e standardit të zbatueshëm të vlerësimit të konformitetit);
- vii. Një analizë që tregon se aktiviteti i përzgjedhur i vlerësimit të konformitetit është i përshtatshëm;
- viii. Identifikimi i kërkesave të aplikueshme nga standardet e tjera përkatëse të përdorura për vlerësimin e konformitetit.

Shënim: Vlefshmëria mund të jetë në terma të auditimeve pilot ose duke demonstruar se skema bazohet në standardet e disponueshme ndërkombëtare ose kombëtare.

11.7 Në rast se PS- jep ndonjë shpjegim mbi SVK-në për ndonjë palë të interesuar, ky informacion duhet të jetë gjithashtu i disponueshëm për DPA dhe OVK-të brenda SVK -së.

11.8 PS duhet të ketë një marrëveshje ligjërisht të zbatueshme me OVK-të që ajo autorizon për përdorimin e SVK-së, e cila, së paku, siguron që OVK-të e përdor SVK –në ashtu sic është formuluar nga PS-ës, pa ndonjë shtesë ose reduktim, dhe të jenë në përputhje me rregullat e PS-ës për aplikimin e simbolit/deklaratës/shenjës, sipas rastit. Në marrëveshje do të përfshihet edhe mënyra sesi do të do të menaxhohet kalimi nga vlerësimi i paakredituar i konformitetit dhe se si ovk-të e reja mund të fillojnë të përdorin SVK-në.

11.9 PS duhet të ketë një procedurë për trajtimin e ankesave në lidhje me SVK-në, duke siguruar që proceset e ankesave të klientëve të OVK-ve, OVK-ve dhe DPA-së të ndiqen me paanëshmëri dhe kompetencë. Hetimi dhe vendimi për ankesat nuk duhet të rezultojë në asnjë veprim diskriminues.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 12 nga 23</p>

Shënim 1: Një përshkrim i procesit të trajtimit të ankesave mund të jetë i disponueshëm publikisht me ose pa kërkesë.

Shënim 2: Udhëzimet për procesin e trajtimit të ankesave janë të disponueshme në ISO 10002.

11.10 PS duhet të ketë një mekanizëm për të ofruar reagime nga DPA mbi funksionimin e SVK-së. Monitorimi i OVK-ve nga PS nuk e përjashton PS-në nga detyrimi i mësipërm. Nëse PS monitoron OVK-të, ai duhet të marrë në konsideratë bashkëpunimin me DPA-në dhe të ketë një mekanizëm reagimi për t'u dhënë informacion mbi performancën e OVK-ve DPA-së.

11.11 PS duhet të ketë një proces për një rishikim periodik të SVK-së duke marrë parasysh përvojën e fituar nga përdorimi i SVK-së dhe reagimet e marra nga palët e interesuara në SVK.

11.12 PS është përgjegjëse për të mbajtur të informuar DPA dhe OVK për çdo informacion dhe zhvillim përkatës në lidhje me SVK, duke përfshirë në veçanti çdo ndryshim të propozuar në kërkesa. Afati për informimin e DPA dhe OVK në rast ndryshimi duhet të jetë i përcaktuar në marrëveshjet respektive. Njoftimi duhet të bëhet përpara zbatimit të ndryshimeve.

11.13 PS duhet të monitorojë zhvillimin dhe rishikimin e standardeve dhe dokumenteve të tjera normative, qofshin ato të tij apo të jashtme, të cilat përcaktojnë kërkesat e specifikuar të përdorura në skemë. Kur ndodhin ndryshime në dokumentet normative të SVK, PS duhet të ketë një proces për të bërë ndryshimet e nevojshme në SVK dhe për të menaxhuar zbatimin e ndryshimeve (p.sh. periudha e tranzicionit) nga klientët e OVK-ve dhe, kur është e nevojshme, palë të tjera të interesuara në SVK.

11.14 Ndryshimet në SVK që ndikojnë në rezultatet e SVK-së, duhet të vërtetohen.

11.15 PS duhet të demonstrojë se ka nevojë dhe mbështetje në treg për SVK-në. Kjo mund të përfshijë demonstrimin e vlerës së shtuar, përfshirjen e palëve të interesuara, iniciativat e qeverisë ose nevojat rregullatore. PS duhet të jete në gjendje të ofrojë dëshmi të nevojës së tregut dhe mbështetje për SVK që vijnë nga palët e interesuara.

Shënim: DPA pranon se numri dhe natyra e 'palëve të interesuara përkatëse' mund të jenë të ndryshme për SVK të ndryshme. Me rëndësi në demonstrimin e nevojës së tregut është këndvështrimi i palëve të interesuara që perfaqësojnë përdoruesit fundorë të SVK (psh konsumatorët ose industria)

11.16 PS- duhet të angazhohet të pranojë rezultatet nga OVK-të e akredituara nga çdo nënshkruar i EA MLA (për qëllimin përkatës) që ndjek kërkesat e përcaktuara në SVK.

11.17 PS duhet të jetë e përgatitur të paguajë për kostot e vlerësimit të SVK-së së tij nga DPA.

11.18 PS-ja duhet të zotohet me shkrim që pajtohet me procedurën e vlerësimit së skemës të përshkruar nga DPA.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 13 nga 21</p>

12 Kërkesat për një SVK

12.1 Procesi i vlerësimit të konformitetit i përshkruar ose zgjedhur nga PS duhet të përfshihet në objektin e njërit prej standardeve EA MLA të Nivelit 3 (shih EA-1/06).

12.2 Kërkesat specifike të skemës, të vendosura në OVK nga PS, nuk duhet të kundërshtojnë, ose të përjashtojnë, asnjë nga kërkesat e përfshira në standardin e përmendur në 12.1.

12.3 Nëse një SVK vendos kërkesa specifike të skemës për DPA, ato nuk duhet të kundërshtojnë ose përjashtojnë ndonjë nga kërkesat në standardin ISO/IEC 17011, Rregulloren e BE-së (EC) 765/2008 dhe, aty ku është e zbatueshme, dokumentet e detyrueshme EA, IAF ose ILAC. Çdo kërkesë për organizmin akreditues duhet të përfshihet në SVK dhe jo në marrëveshjen kontraktuale ndërmjet DPA dhe PS.

Kërkesat specifike të skemës për organizmin akreditues për SVK-të ndërkombëtare kërkojnë miratim specifik nga EA HHC. Nëse një SVK kombëtare synon të zgjerohet për t'u bërë ndërkombëtare, atëherë çdo marrëveshje me organizmin akreditues për kërkesat shtesë sipas ISO/IEC 17011 do të konsiderohen si kërkesa specifike të Skemës për organizmin akreditues dhe nuk do të jenë automatikisht të detyrueshme për organizmat akreditues të tjerë. Këto kërkesa specifike fillimisht do të duhet të pranohen dhe miratohen nga EA HHC.


12.4 SVK në sektorin vullnetar as nuk duhet të kundërshtojnë dhe duhet të përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, përveç rasteve kur është pranuar nga autoritetet kompetente dhe nuk krijon ndonjë konfuzion ndërmjet SVK dhe detyrave të autoriteteve (psh mekanizmi monitorues) ose ndërmjet rolit të OVK dhe atij të autoritetit kompetent në fjalë.

12.5 SVK duhet të mbulojë elementët e mëposhtëm:

- i) Përzgjedhja e objektit(ëve) të vlerësimit të konformitetit, duke përfshirë zgjedhjen e kërkesave të specifikuara për t'u vlerësuar dhe planifikimin e aktiviteteve të mbledhjes së informacionit dhe marrjes së mostrave;
- ii) Përcaktimi, duke përfshirë përdorimin e një ose më shumë metodave të përcaktimit (p.sh. testimi, auditimi dhe/ose ekzaminimi) për të zhvilluar informacion të plotë në lidhje me përmbushjen e kërkesave të specifikuara nga objekti i vlerësimit të konformitetit ose mostra e tij;
- iii) Shqyrtimi, vendimi dhe vërtetimi, duke përfshirë shqyrtimin e provave nga faza e përcaktimit. Konkluzioni i bazuar në rezultatet e rishikimit nëse është demonstruar përmbushja e kërkesave të specifikuara dhe një vërtetim pasues se objekti i vlerësimit të konformitetit është demonstruar në mënyrë të besueshme për përmbushjen e kërkesave të specifikuara, dhe çdo shënim ose licencim pasues dhe kontrollat përkatëse të tyre, aty ku është e aplikueshme; dhe
- iv) Mbikëqyrja dhe ricertifikimi, sipas rastit, përsëritja sistematike e aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit si bazë për ruajtjen e vlefshmërisë së deklaratës së konformitetit.

12.6 Një SVK duhet të përfshijë sa vijon:

- i) objektivat e skemës për industrinë ose grupin e përdoruesve të veçantë;

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	Kodi: DA-PM-008
		Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024
		Faqe 14 nga 21

- ii) Objekti i vlerësimit të konformitetit, p.sh. produkt ose proces ose person ose pretendim
- iii) Kërkesat ndaj të cilave duhet të vlerësohet konformiteti;
- iv) Procesi i vlerësimit të konformitetit që përdoret për të përcaktuar konformitetin e objektit. Ky proces do të përfshihet në objektin e njërit prej standardeve të IAF MLA të Nivelit 3 pa asnjë kontradiktë apo përjashtim;
- v) çdo aplikim ose shpjegim specifik të ISO/IEC 17011 (p.sh. kriteret specifike të kompetencës për vlerësuesit/ekspertët teknikë/grupet e vlerësimit, kriteret e vlerësimit, detaje specifike në raportet e vlerësimit), nëse është e aplikueshme; dhe
- vi) Çdo aplikim apo shpjegim specifik i standardit të akreditimit në Nivelin 3, p.sh. ISO/IEC 17021-1, ISO/IEC 17065, ISO/IEC 17024/ ISO/IEC 17029 (p.sh. kriteret specifike të kompetencës për auditorët/vlerësuesit/inspektorët/ekspertët teknikë/grupet e auditimit, kriteret e auditimit/vlerësimit/inspektimit, detaje specifike në raportet e auditimit/vlerësimit/inspektimit), nëse është e aplikueshme.

12.7 Kur është e aplikueshme, kërkesat në SVK duhet të shkruhen në terma të rezultateve së bashku me vlerat kufizuese dhe tolerancat.

12.8 Kërkesat në SVK duhet të deklarohen pa mëdyshje duke përdorur formulime që janë objektive, logjike, të vlefshme dhe specifike dhe të mundësojnë zbatimin e qëndrueshëm nga organizatat si dhe vlerësimin nëpër OVK.

12.9 Kur SVK përfshin kërkesa ligjore, këto duhet të formulohen në mënyrë të tillë që pajtueshmëria të jetë një kusht për rezultatin e vlerësimit të konformitetit.

12.10 SVK duhet të përshkruajë metodën e përdorur për të monitoruar që certifikata ose vërtetimi ose mbajtësi i deklaratës vazhdojnë të jenë në përputhje me kërkesat, nëse është e aplikueshme.

12.11 Kur autorizimi i PS jepet përpara akreditimit, që nënkupton se OVK-ja mund të kryejë aktivitete të vlerësimit të konformitetit të mbuluara nga SVK dhe mund të ketë të drejtën të përdorë shenjën e PS-se, SVK do të kërkojë nga OVK-të për t'u akredituar në një periudhë të caktuar kohore.

12.12 SVK duhet të specifikojë deklaratën e konformitetit që shfaqet në dokumentet e vlerësimit të konformitetit.

12.13 Kur SVK parashikon përdorimin e certifikatave, markave ose deklaratave të tjera të konformitetit, duhet të ketë një licencë dhe/ose rregulla ose një formë tjetër marrëveshjeje të detyrueshme për të kontrolluar një përdorim të tillë. Licencat mund të përfshijnë dispozita në lidhje me përdorimin e certifikatës, markës ose deklaratës tjetër të konformitetit në komunikimet në lidhje me objektin e vlerësimit të konformitetit dhe kërkesat që duhen përmbushur kur certifikimi nuk është më i vlefshëm.

12.14 SVK mund të specifikojë një mënyrë me të cilën PS monitoron OVK-të, përtej kërkesës që OVK-të akreditohen sipas kërkesave të SVK-së.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 15 nga 21</p>

13. PROCESI I VLERËSIMIT TË NJË SVK NDËRKOMBËTARE

Përpara vlerësimit të një SVK për qëllimet e akreditimit të OVK(ve) që punojnë brenda SVK-së, DPA duhet të sigurojë që EA nuk ka emëruar tashmë një hAB për atë SVK (informacioni mbi hAB-et e emëruara është i disponueshëm në intranetin EA). Nëse një hAB tashmë është emëruar, atëherë DPA nuk ndërmerr asnjë vlerësim, por ndjekë udhëzimet e dhëna nga hAB.

Nëse asnjë hAB nuk është emëruar nga EA, përpara se të fillojë vlerësimi i një SVK-je, PS informon DPA, me shkrim, nëse synon të operojë SVK në më shumë se një vend të EA dhe si rrjedhim, pranon të ndjekë procedurën e vlerësimit të përshkruar në pikën 13 të kësaj procedure.

Nëse asnjë hAB nuk është emëruar, DPA përdor formularët DA-FO- 079 dhe DA-FO-080. Organizmi akreditues do t'i njoftojë PS- aplikues për periudhën kohore të parashikuar të nevojshme për vlerësim. Do të mbahen shënime të vlerësimit, duke përfshirë bazën mbi të cilën është marrë vendimi për praninë. Organizmi akreditues do të përdorë modelin e raportit të disponueshëm në intranetin EA.

Nëse PS të një svk-je që operon në disa vende zgjedh të mos ndjekë procedurën e përshkruar në pikën 13 të kësaj procedure, DPA do të informojë PS me shkrim se nuk do të ketë hAB dhe se organizmat akreditues tjerë të EA nuk do të jenë të detyruara të ndjekin një qasje dhe për këtë arsye ai do të duhet të merret me çdo organizëm akreditues ku operon veçmas, dhe për rrjedhojë të pranojë çdo ndryshim në qasje nga ana e tyre.

Nëse synimi fillestar është të operojë svk-në në vetëm një vend, DPA do të informojë PS se SVK do të vlerësohet vetëm në nivel kombëtar dhe se nëse situata ndryshon në të ardhmen, dhe PS dëshiron të ketë një qasje të përbashkët në të gjitha vendet e EA, procesi i vlerësimit i përshkruar në pikën 13 të kësaj procedure do të duhet të zbatohet. Në këtë rast, vendimet e DPA që vlerësojnë SVK-në mund të ndryshojnë për këtë SVK.

13.1 Hapat e vlerësimit të një SVK ndërkombëtare të re nga DPA

Hapi 1: Marrëveshja e PS-së dhe zgjedhja e hAB.

Përpara fillimit të një vlerësimi të një SVK ndërkombëtare, DPA duhet të marrë njoftim me shkrim nga PS:

- se është i vetëdijshëm për faktin se DPA do të jetë hAB për atë svk dhe do të punojë me hAB pa kontakt me organizmat akreditues të tjera EA në lidhje me këtë svk derisa të përfundojë vlerësimi;
- nëse SVK përfshin kërkesa shtesë për ISO/IEC 17011, Rregulloren (EC) 765/2008 dhe/ose, sipas rastit, dokumentet e detyrueshme EA dhe dokumentet IAF ose ILAC të miratuara nga EA si të detyrueshme. Nëse po, atëherë kërkohet gjithashtu konfirmim me shkrim që PS-ja është në dijeni të faktit se këto kërkesa shtesë do të

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 16 nga 21</p>

duhet të miratohen nga EA përpara se të fillojë procesi i vlerësimit nga DPA; që një miratim i tillë nga EA nuk është një rezultat i garantuar; dhe se procesi i miratimit mund të ndikojë në kohën e procesit të vlerësimit.

- se pranon të ndjekë procedurën e vlerësimit të përshkruar në 11 të kësaj procedure.

Hapi 2: Regjistrimi EA i SVK-së në proces

Pasi të jetë marrë ky njoftim, DPA-ja do të informojë Sekretariatit e EA se i ka ardhur një kërkesë nga PS dhe synon të kryejë vlerësimin fillestar. DPA do të angazhohet të jetë hAB.

Hapi 3: Analiza nga hAB


Sekretariati i EA do të informojë të gjithë anëtarët e EA se një SVK e re është në vlerësim dhe cila do të jetë hAB (DPA) për këtë svk. Regjistrimet për këtë do të mbahen në intranetin e EA. Gjatë këtij hapi, hAB(DPA) dhe organizmat e tjerë akreditues nuk do të ofrojnë akreditim për ovk-të në lidhje me këtë SVK.

Pasi hAB (DPA) të ketë kryer vlerësimin fillestar të një SVK-je që do të operohet në disa vende anëtare të EA, ajo do t'i raportojë rezultatin e vlerësimit Sekretariatit të EA. Ky rezultat duhet të përfshijë:

- Një raport që jep dëshmi mbi elementët në formularin DA-FO-080 që mbështet arsyen pse DPA e konsideron skemën në përputhje me kërkesat e kësaj procedure.
- Në rast se PS ka vendosur kërkesa specifike të Skemës për organizmat e tjerë akreditues (pika 4.11 e formularit DA-FO-080), raporti do të përfshijë një referencë të qartë për to dhe arsyetimin e përdorur nga hAB (DPA) për të vendosur që ato janë të pranueshme bazuar në justifikimin e bërë nga PS.
- Konfirmimi i standardit që do të përdoret për akreditimin e OVK-ve, duke përfshirë arsyetimin pse është zgjedhur standardi.
- Shprehja e fushës së akreditimit duke përfshirë dokumentet që do të citohen dhe shkallën e fleksibilitetit të mundshëm, siç përcaktohet nga hAB (DPA) dhe është rënë dakord me PS-në. Kjo shprehje e fushës do të jetë ajo e përdorur nga të gjitha organizmat e tjerë akreditues që ofrojnë akreditimin e ovk-ve në lidhje me këtë
- Dokumentacioni (ose një link me dokumentacionin) e Svk- se (në anglisht).

Hapi 4: Konsultimi me EA

Sekretariati i EA do të qarkullojë dokumentet Svk dhe raportin e vlerësimit të hAB (DPA) tek organizmat e tjerë akreditues për një periudhë 30-ditore për komente. Në rast se PS ka vendosur kërkesa specifike të Skemës për organizmat e tjerë akreditues, sekretariati i EA do t'u kërkojë anëtarëve të EA 2 grupe të veçanta komentesh (në të njëjtën periudhë) për këtë çështje: një për komentet mbi rezultatet e vlerësimit të Svk nga hAB (DPA), dhe një i dedikuar për komentet mbi kërkesat specifike të skemës të vendosura për organizmat e tjerë akreditues.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 17 nga 21</p>

Derisa të finalizohet faza e komentimit, rekomandohet që hAB (DPA) dhe organizmat e tjerë akreditues të mos fillojnë aktivitetet e vlerësimit në lidhje me svk-në nën vlerësim, përveç rasteve nëse nevoja për të filluar vlerësimin përpara përfundimit të periudhës së komentimit mund të justifikohet plotësisht. Në raste të tilla, hAB dhe organizmat e tjerë akreditues duhet t'i bëjnë PS-së dhe OVK-ve që synon të vlerësojë në mënyrë eksplicite të vetëdijshme se konkluzionet e saj mund të ndryshohen nga anëtarët e tjerë organizma akreditues dhe se kjo mund të rezultojë në ndryshime në qasjen e vlerësimit dhe ose kërkesat e svk-së. Megjithatë, kur puna e vlerësimit fillon përpara se të finalizohet faza e komentimit, akreditimi nuk mund të jepet përpara se të pranohet SVK-ja.

Hapi 5: Konkluzionet dhe regjistrimi në listen e SVK-ve të pranuar nga EA.

Pasi të ketë mbaruar periudha e komenteve, nëse nuk janë marrë komente negative, atëherë konkluzionet e hAB (DPA) konfirmohen dhe Sekretariati do të informojë të gjitha organizmat e tjere akreditues për përfundimet dhe se të gjitha organizmat e tjere akreditues mund të operojnë skemën.

Pas vlerësimit të suksesshëm të svk-së, emri i svk, duke përfshirë numrin e versionit dhe/ose datën dhe standardin e vlerësimit të konformitetit të përdorur për akreditim, do të publikohet brenda zonës "Vetëm anëtarët" të Intranetit të EA ku një listë mbahet nga Sekretariati i EA i SVK të vlerësuar sipas EA-1/22 dhe hAB (DPA) mban përgjegjësinë si pikë kontakti për SVK-në.

Aty ku jo të gjitha modulet ishin pjesë e vlerësimit, vetëm modulet e vlerësuara do të identifikohen në listë. Lista do të përfshijë fushën e akreditimit të shprehur siç përcaktohet në hapin 3 si dhe datën e fillimit të tranzicionit aty ku është e aplikueshme, gjithashtu edhe datën e përfundimit.


Hapi 6: Procesi i trajtimit të komenteve negative

Nëse është marrë ndonjë koment negativ, atëherë Sekretariati i EA do t'i raportojë ato tek hAB (DPA) për zgjidhje në shkallën e parë. hAB (DPA) do të kontaktojë me organizmat e tjere akreditues komentuese për të arritur një konsensus. Nëse konsensusi nuk arrihet, çështja do të përshkallëzohet në EA HHC për diskutim dhe vendim që përfshin, nëse dhe kur është e nevojshme, një grup pune që përbëhet nga hAB (DPA), organizmat akreditues që kanë dhënë komentet, organizmat e tjerë akreditues vullnetarë dhe PS-se. Si mundësi e fundit për të marrë një vendim, kryetari i HHC-së mund të vendosë të votojë.

Nëse komentet negative kanë të bëjnë vetëm me kërkesat specifike të skemës të vendosura në organizmat akreditues, duke mos kundërshtuar ose përjashtuar asnjë nga kërkesat në ISO/IEC 17011, standardin e përdorur për akreditimin, Rregulloren e BE-së (EC) 765/2008 dhe, kur është e aplikueshme, dokumentet e detyrueshme EA dhe dokumentet IAF ose ILAC të miratuara nga EA si të detyrueshme, një organizem akreditues mund të vendosë të fillojë të operojë skemën, përpara përfundimit të procesit.

Nëse pas procesit, skema nuk pranohet në nivel EA, është përgjegjësi e çdo organizmi akreditues në mënyrë individuale të vendosë për të operuar skemën në një marrëdhënie dypalëshe me PS-në, por vetëm nëse kushtet në fjalinë e mësipërme plotësohen plotësisht.

Në rastin kur kërkesat (duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, kërkesat specifike të skemës për organizmin akreditues) nuk pranohen, skema nuk do të përfshihet në listë. Qasja hAB (DPA) është ndërprerë dhe PS do të informohet nga Sekretariati i EA për rezultatin dhe arsyetimin.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 18 nga 21</p>

PS do të marrë dokumentet e vlerësimit të cilat do t'i lejojnë PS-së të përdorë dokumentacionin në aplikimet eventuale të PS-së për cdo organizëm akreditues nëmënyrë individuale.

Ndryshimet e një SVK ndërkombëtare

PS do të informojë hAB sa më shpejt të jetë e mundur për çdo rishikim të propozuar për të gjithë ose për një pjesë të SVK-së. Ky informacion do të identifikojë të gjitha ndryshimet në svk dhe do të sigurojë një vlerësim të dokumentuar të ndikimit të tyre në vlerësimin fillestar të svk-së. Kur është e aplikueshme, PS do të përfshijë gjithashtu informacion mbi kërkesat e tranzicionit (p.sh. afati dhe marrëveshjet për OVK-të dhe për klientët e OVK-ve).

hAB (DPA) informon organizmat e tjere akreditues active (ofrojnë akreditim për këtë skemë) dhe sekretariatit e EA se ka marrë një kërkesë për të vlerësuar një rishikim të svk-së dhe se komunikimi i mëtejshëm do të vijojë nga hAB(DPA).

hAB(DPA) do të vlerësojë ndikimin në procesin e akreditimit dhe në vlefshmërinë e SVK. Nëse standardi i vlerësimit të konformitetit do të ndryshonte, atëherë kjo do të kërkonte një vlerësim të plotë të SVK-së siç përshkruhet në pikën 13. E njëjta gjë vlen në rast se ka kërkesa shtesë për organizmat akreditues.

Vlerësimi i ndryshimeve të propozuara në svk do të drejtohet nga hAB (DPA) që përfshin të gjitha organizmat akreditues aktiv.

hAB (DPA) do të mbajë shënime për komunikimin me PS, organizmat e tjera akredituese aktive dhe për konkluzionet dhe vendimet.

hAB (DPA) do t'i dërgojë rezultatet e vlerësimit dhe dokumentacionin tek organizmat akreditues te tjera për një periudhë komentimi. Kjo periudhë normalisht do të jetë jo më pak se 30 ditë edhe pse hAB (DPA) mund ta rrisë atë nëse vëllimi ose rëndësia e ndryshimeve rekomandon një periudhë më të gjatë.


Në rast të komenteve, PS do të informohet nga Hab (DPA). PS do të ndërmarrë veprimet e duhura për komentet e dhëna të cilat nuk bien ndesh me periudhën e tranzicionit.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të versionit të ri të SVK-së, sekretariati i EA do të përditësojë listën EA të svk-së të vlerësuar me datën e rishikimit dhe ose numrin e svk-së dhe do të informojë të gjitha organizmat akreditues në përputhje me rrethanat.

Pranimi nga DPA i një SVK-je të vlerësuar nga organizma të tjerë akreditues

1. Nëse Hab është anëtare e EA-së dhe skema është pranuar nga EA.

Në rastet kur në DPA do të vijë një aplikim për vlerësimin e një svk e cila rezulton se kjo svk është vlerësuar nga një Hab që është anëtare e EA-së dhe skema është publikuar në intranetin EA, DPA do të informojë hAB dhe në përputhje me EA-1/06 5 (p), do ta bëjë publikisht të aksesueshme në faqen e të internetit, se DPA tani po ofron akreditim për këtë SVK.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	<p>Kodi: DA-PM-008</p>
		<p>Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024</p>
		<p>Faqe 19 nga 21</p>

Çdo pyetje që do të ketë DPA për PS-në në lidhje me SVK-në do të ngrihet nëpërmjet hAB-së.

2. Nëse një SVK është vlerësuar nga një hAB që është anëtare e EA-së por skema nuk ka njohje në EA.

Në rastet kur në DPA do të vijë një aplikim për vlerësimin e një svk e cila rezulton se kjo svk është vlerësuar nga një Hab që është anëtare e EA-së dhe skema nuk është e njohur nga EA, DPA do të ndjekë procedurën e vlerësimit të skemës së vlerësimit të konformitetit. Në këtë rast Dpa mund ti kërkoj dokumentacionin e vlerësimit Hab.

3. Nëse një svk kombëtare kërkon të zhvillohet në një svk ndërkombëtare

Nëse një svk kombëtare kërkon të zhvillohet në një svk ndërkombëtare në këtë rast organizmi akreditues që ka akredituar OVK sipas kësaj SVK-je do të emërohet si hAB për këtë skemë dhe procesi do të zhvillohet sipas pikës 13 të kësaj procedure.

14. Ndryshimet në kërkesat e akreditimit.

Në rast se kërkesat e akreditimit ndryshojnë, DPA ndjek gjithmonë udhëzimet e organizatave ndërkombëtare.

Në bazë të udhëzimeve të organizatave ndërkombëtare, DPA përgatit planin për periudhën e tranzicionit për futjen e sistemit të kërkesave të modifikuara. Plani përmban detyrat e DPA dhe të organeve të akredituara, duke specifikuar gjithashtu afatet.

Detyrat e DPA për periudhën e tranzicionit.

Në bazë të kërkesave të modifikuara dhe udhëzimeve ndërkombëtare DPA përcakton hapat dhe afatet për organet e akredituara, për të siguruar kohë për përgatitjen e sigurt dhe vlerësimin e përmbushjes së kërkesave.


DPA informon organet e akredituara dhe aplikantët rreth ndryshimeve të kërkesave në faqen e saj të internetit.

DPA i bën thirrje organeve të akredituara me anë të një komunikimi se ato duhet të përgatisin dhe dorëzojnë planet e tyre për periudhën e tranzicionit brenda afatit të caktuar.

DPA organizon kurset e trajnimit të nevojshme për përgatitjen e duhur të stafit të brendshëm dhe vlerësuesve të jashtëm.

DPA pasi vlerëson dhe mbledh planet e tranzicionit, përgatit planin e saj të tranzicionit si pjesë e planit të auditimit.

Në rast se kërkesat ndryshohen, organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit përcaktojnë një periudhë tranzicioni. Pas skadimit të periudhës së tranzicionit, akreditimi për organet e akredituara që nuk i përmbushin kërkesat e reja revokohet nga DPA, ose revokimi mund të kërkohet vullnetarisht.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</p>	Kodi: DA-PM-008
		Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024
		Faqe 20 nga 21

Gjatë periudhës së tranzicionit, organi i akredituar do të marrë parasysht datën e lëshimit të standardit përkatës kur përcakton datën e skadimit të certifikatave të dhëna sipas standardit përkatës. Prandaj, data e skadimit nuk mund të jetë më vonë se fundi i periudhës së tranzicionit dhe certifikatat e dhëna sipas standardeve të pavlefshme bëhen të pavlefshme.

DPA konfirmon konformitetin e aktivitetit të certifikimit të organeve të akredituara në kuadrin e procedurës së akreditimit dhe procedurës vjetore të mbikëqyrjes/ ose procedurës së mbikëqyrjes jashtëzakonshme. Organi i akredituar mund të lëshojë certifikim të ri sipas standardeve të reja vetëm pasi të kalojë tranzicionin në mënyrë të suksesshme.

Detyrat e organeve të akredituara për periudhën e tranzicionit.


Në mënyrë që DPA të planifikojë programin e akreditimit të kalimit në standardin e ri, organet e akredituara duhet të dorëzojnë në sekretariatit e DPA-së planin për periudhën e tranzicionit, për kalimin në akreditim sipas standardeve të reja brenda afatit të përcaktuar nga DPA.

Gjatë përgatitjes së planit të tranzicionit, duhet të merren parasysht:

- a) trajnimi i stafit të brendshëm, auditorëve, vlerësimi i kompetencave;
- b) Informimi i klientëve ekzistues dhe të ardhshëm për periudhën dhe kërkesat e tranzicionit;
- c) rishikimi i planit të auditimit dhe certifikimit;
- d) rishikimin e periudhës së certifikimit dhe ciklit të tranzicionit;
- e) koha e nevojshme për marrjen e vendimeve të certifikimit për azhurnimin e certifikatave.

15. Regjistrimet

Titulli i dokumentit	Kush e plotëson	Kur e plotëson	Kush e ruan
DA-FO-079	Aplikuesi	Kur aplikon për vlerësimin e skemës së vlerësimit të konformitetit	Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve			Kodi: DA-PM-008
				Rishikim nr 7 Dt: 14.11.2024
				Faqe 21 nga 21
DA-FO-080	Grupi i punës	Në përfundim të vlerësimit të skemës	Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit	

16. Historiku

Data ripunimit	Numri i rishikimit	Hartoi	Përshkrimi i ndryshimeve
30.10.2006	0	Aleks Cuni	Versioni fillestar
30.10.2009	1	Ermira Fyshku Besnik Pani	Ndryshime në pikën 4 referimet, logo e DPA dhe ndreqja e gabimeve ortografike Është shtuar një paragraf në pikën 7.1.1 në lidhje me trajnimin e stafit
20.05.2010	2	Ermira Fyshku	Ndryshime në pikën 3 dhe 6.1.3 në lidhje me përgjegjësinë e drejtorit të zhvillimit. Ndryshime në pikën 7.1.1 në lidhje me paragrafin 4.6.3 të standardit ISO/IEC 17011 si dhe në pikën 7.2 në lidhje me paragrafin 4.6.2; 4.6.3 c të standardit ISO/IEC 17011
22.12.2014	3	Ermira Fyshku	Ndryshime në header dhe lidhur me legjislacionin e ri
20.05.2019	4	Suela Kromidha	Implementimi i standardit ISO/IEC 17011:2017
10.09.2019	5	Suela Kromidha	Ndryshime ne paragrafet 7, 8 dhe 9
31.03.2021	6	Suela Kromidha	Ndryshime ne paragrafet 7, 8 dhe 9
14.11.2024	7	Suela Kromidha Emiliana Muca	Ndryshime në paragrafët 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11,12,13 dhe 14



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

**Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i
skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt
standardeve**

Kodi: DA-PM-008

Rishikim nr 7
Dt: ____/____/2024

Faqe 11 nga 14

